



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr . 01 Datë 24 / 01 /2020

PËR

**“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË
TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NË
6% TË FONDIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”**

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (ndryshuar), bazuar në VKM 955 datë 07.12.2016 “ Për Përcaktimin e Krieteve, Dokumentacionit dhe Masës së Ndiemes Ekonomike”, si dhe bazuar në Udhëzimin Nr. 5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 %”.

VENDOSI

Të miratohen kriteret specifike per Vitin 2020 mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Këshillit Bashkiak për të trajtuar me Ndihmë Ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, familjet të cilat nuk shpallen fituese sipas formulës së pikëzimit.

1. Familje të varfëra të cilat nuk plotësojnë nevojat bazike për jetesë.
2. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antare me paaftësi/invalidë pune;
3. Familje me shumë fëmijë
4. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
5. Personat që jetojnë vetëm/ të moshuar.
6. Familje që kanë në përbërje antarë mbi moshë pune dhe që nuk marrin as pension.
7. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin;
8. Familjet që nuk kanë banesë për të jetuar apo jetojnë me qera.